

[www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)



REVISTA DIGITALE

# DIALOG JURIDIK

REFLEKTIME GJYQËSORE

2026

***Juridiksion kushtetues apo gjyqësor?***  
***Reflektim mbi shtrirjen e juridiksionit e Gjykatës Kushtetuese te vendimmarrja e Gjykatës së Lartë***

**Sokol Sadushi**  
*Kryetar i Gjykatës së Lartë*  
*(ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, profesor i së drejtës)*

## **I. Hyrje**

Ka një debat, megjithëse ende jo publik, lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit të Gjykatës së Lartë (GJL) dhe Gjykatës Kushtetuese (GJK). Unë po e sjell sot këtë temë në platformën elektronike të dialogut gjyqësor, duke marrë nxitje nga diskutimi i gjyqtarit të GJK, Asim Vokshi, lidhur me sugjerimin e tij të drejtë sa i takon *“rishikimit të mënyrës së funksionimit të Gjykatës së Lartë, me qëllim rritjen e efikasitetit të saj dhe harmonizimin e rolit të kësaj gjykate me funksionin që i është njohur shprehimisht nga neni 141 i Kushtetutës... Funksioni kushtetues i Gjykatës së Lartë nuk është zëvendësimi i rolit të gjykatave të apelit, apo ndryshimi i vendimmarrjeve të tyre vetëm mbi baza të qëndrimit apo mendimit të ndryshëm nga gjyqtarët për mënyrën e zgjidhjes së çështjes (kur nuk ngrihen problematika themelore), por identifikimi i qartë i çështjeve me rëndësi themelore që lidhen me njësimin, zhvillimin dhe sigurinë e praktikës gjyqësore dhe dhënia e vendimeve të themelit vetëm për këtë kategori çështjesh, nga kolegj kompetent.”*. Pajtohem me sugjerimin e gjyqtarit Vokshi. Prandaj, më duhet të ndalem te një faktor, i cili për fat të keq, nuk kontribuon në këtë përpjekje të GJL, për të ushtruar tërësisht rolin e saj kushtetues.

Ndërkohë që GJL po tregon çdo ditë e më shumë prirjen për të qenë gjykatë e ligjit (dhe jo e faktit), ajo ndeshet me një rezistencë, e cila, ndryshe nga sa pritet, nuk vjen nga palët apo gjykatat më të ulta, por nga vetë GJK. Kjo gjykatë tashmë e ka kthyer në praktikë të zakonshme gjetjen e mangësive në arsyetim të vendimeve të GJL, duke i kërkuar asaj që t'i japë përgjigje çdo pretendimi të palëve, pavarësisht nëse përbën shkak për rekurs. Mjafton që pretendimi të ketë “veshje kushtetuese” dhe kjo përbën, sipas saj, shkak për të marrë në shqyrtim rekursin.

## **II. Funksioni i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës Kushtetuese**

Sipas nenit 141 të Kushtetutës, Gjykata e Lartë është gjykatë e ligjit, me rol në njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ky funksion është i lidhur ngushtë me kufijtë proceduralë të rekursit, që përcaktohen shprehimisht nga ligji. Nga kjo rrjedh se Gjykata e Lartë vepron brenda shkaqeve të paraqitura dhe nuk ka një kompetencë të përgjithshme për rishqyrtim në themel të çështjes.

Neni 131 i Kushtetutës i njeh Gjykatës Kushtetuese një juridiksion kontrolli dhe jo kasacional. Ajo verifikon nëse vendimmarrja gjyqësore ka respektuar standardet kushtetuese, veçanërisht në lidhje me arsyetimin, mungesën e arbitraritetit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore. Në këtë kuptim, kontrolli kushtetues zakonisht përqendrohet në pyetje të tilla si:

- nëse pretendimet thelbësore janë identifikuar;
- nëse është dhënë një arsyetim i kuptueshëm;
- nëse vendimi shmang kontradiktat dhe arbitraritetin.

### **III. Çfarë tregon jurisprudenca e GJK?**

Jurisprudenca e viteve të fundit tregon disa prirje që meritojnë vëmendje, pasi duket se nuk pajtohen tërësisht me funksionin e kontrollit kushtetues, por me atë gjyqësor.

*Së pari*, Gjykata Kushtetuese e ka gjetur brenda juridiksionit të saj që të shprehet se Gjykata e Lartë duhet të kalojë një çështje për njësim ose zhvillim të praktikës, duke dhënë udhëzime që prekin hapësirën vlerësuese të GJL (*shih vendimet nr. 82/2016 dhe nr. 66/2023*).

*Së dyti*, GJK rregullisht thekson se pretendimet me natyrë kushtetuese kërkojnë një trajtim më të thelluar nga GJL (*shih vendimet nr. 10/2025, nr. 7/2025, nr. 50/2025, nr. 14/2026*). Kjo qasje, në disa raste, mund të perceptohet si një zgjerim funksional i filtrit të rekursit përtej parashikimeve ligjore, të cilat kanë parashikuar qartë shkaqet e rekursit, duke mos i lidhur me natyrën kushtetuese të pretendimit, ndryshe nga sa arsyetohet nga GJK.

*Së treti*, GJK ka hyrë në mënyrën e kualifikimit juridik të çështjes, duke identifikuar elemente që, sipas saj, duhej të ishin trajtuar nga GJL, gjë e cila është tërësisht në fushën e juridiksionit gjyqësor, dhe jo atij kushtetues (*shih vendimet nr. 11/2026 dhe nr. 77/2025*).

*Së fundi*, kontrolli kushtetues shoqërohet me analiza të zgjeruara të natyrës materiale, të cilat afrohen me vlerësimin e themelit të çështjes, ku është e vështirë të kuptohet ndarja e juridiksionit kushtetues me atë gjyqësor në disa raste (*shih vendimet nr. 82/2025 dhe nr. 67/2025*).

### **V. Vlerësim i përgjithshëm**

Këto zhvillime nuk përbëjnë domosdoshmërisht një ndryshim të drejtpërdrejtë të modelit kushtetues, por tregojnë një tendencë drejt një ndërveprimi më intensiv ndërmjet dy juridiksioneve, të cilat meritojnë vëmendje dhe adresim nga gjyqtarët e të dyja gjykatave të larta. Në disa raste, ky ndërveprim duket se shkon përtej kufijve tradicionalë të kontrollit kushtetues, duke prekur elemente që lidhen me mënyrën se si GJL ushtron funksionin e saj kasacional. Kjo vihet re veçanërisht kur:

- vlerësohet nëse një çështje kërkon njësim ose zhvillim të praktikës;
- trajtohet natyra kushtetuese e pretendimeve si faktor që e bën rekursin të pranueshëm tej shkaqeve që parashikon ligji procedural;

- identifikohen elemente konkrete të çështjes që, sipas GJK, duhej të ishin trajtuar nga GJL;
- kur analiza kushtetuese shoqërohet me vlerësime që afrohen me shqyrtimin e themelit të çështjes.

Qartësimi i kufijve funksionalë, në mënyrë që të shmanget mbivendosja e roleve dhe perceptimi i GJK si “instance rishikuese gjyqësore”, duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme, pasi vetëm në këtë mënyrë shmanget pasiguria juridike dhe qartësia në veprimtarinë e gjykatave, sidomos kur bëhet fjalë për dy gjykatat më të larta në vend.

Ruajtja e ekuilibrit midis dy juridiksioneve kërkon që secila gjykatë të ushtrojë kompetencat e saj pa u shtrirë në fushën funksionale të tjetrës, duke garantuar kështu koherencën e sistemit dhe sigurinë juridike.